



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 2011 prot.

Shkodër, më 31.01. 2025

**VENDIM
Nr. 6 datë 30.01.2025**

“PËR NJË NDRYSHIM NË EMËRTIMIN DHE NDRYSHIMIN E FUSHËS SË PËRDORIMIT TË PJESSHËM NË VKB NR. 51 DATË 14.04.2009 “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË PJESSHME TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE QË KËRKOHEN PËR TRANSFERIM NË PRONËSI TË BASHKISË SHKODËR”, MIRATUAR ME VKM NR. 421 DATË 02.06.2010, TË NDRYSHUAR, SIPAS LIDHJES 1, TË PRONËS ME NUMËR RENDOR 13, SIPAS FORMULARIT PËR INVENTARIZIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE”.

Këshilli i Bashkisë në mbledhjen e datës 30.01.2025, mbështetur në ligjin Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshua, neni 9, pika 1.2 germa “a” dhe “c”; ligjin Nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar; ligjin Nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar; VKM-në Nr.421, datë 02.06.2010 “Për miratimin e listës përfundimtare (të pjesshme) të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Shkodër, të Qarkut të Shkodrës” të ndryshuar; Çertifikatat e Pronësisë me numra 066039,066040 dhe sipas dolumentacionit të përgatitur nga administrata e Bashkisë Shkodër,

VENDOSI :

1.Të miratojë ndryshimin në emërtimin e objektit dhe ndryshimin e fushës së përdorimit të pjesshëm në VKB Nr.51 datë 14.04.2009 “Për miratimin e listës së pjesshme të pronave të paluajtshme shtetërore që kërkohen për transferim në pronësi të Bashkisë Shkodër”, miratuar me VKM-në Nr.421, datë 02.06.2010 “Për miratimin e listës përfundimtare (të pjesshme) të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Shkodër, të Qarkut të Shkodrës”, të ndryshuar, me numër rendor inventarizimi Nr.13, Objekti “Magazina ish-Hotel-Sporti truall dhe ndërtesë që ndodhen në Zonën Kadastrale 8594 si më poshtë:

Ishte : Emërtimi i Objektit “Magazinë Ish Hotel Sporti”

Adresa: Rr. “13 Dhjetori”, Nr.1, Shkodër, web: www.bashkiashkoder.gov.al, e-mail: info@bashkiashkoder.gov.al

Fusha e përdorimit : Administrative

Nr. Rend.	Zona Kadastr. & Indeksi i Hartës	Nr. Pasurisë	Lloji i Pronës	Emri i Pronës Adresa	Sip. Totale e Pronës(m ²)	Nga Sip. Totale: Sa Ndërtesë(m ²)	Funksioni për të cilin përdoret Prona	Institucioni / Enti me përgjegjësi administrative	Institucioni / Enti përdorues Statusi juridik i përdorimit	Të dhëna të tjera(Shenime të veçanta)
2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	
13	8594 N-8	5/351	Truall,Ndërtese	Magazina ish Hotel Sporti	257	257	Magazinë	Bashkia Shkodër	Bashkia Shkodër	Kati I -rë

Bëhet : “ Emertimi i Objektivit “ Qendër Shëndetësore ”

Fusha e përdorimit : Shërbim Shëndetësor

Nr. Rend.	Zona Kadastr. & Indeksi i Hartës	Nr. Pasurisë	Lloji i Pronës	Emri i Pronës Adresa	Sip. Totale e Pronës(m ²)	Nga Sip. Totale: Sa Ndërtesë(m ²)	Funksioni për të cilin përdoret Prona	Institucioni / Enti me përgjegjësi administrative	Institucioni / Enti përdorues Statusi juridik i përdorimit	Të dhëna të tjera(Shenime të veçanta)
2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	
13	8594 N-8	5/312+1-5	Ndërtesë Truall	Qendër Shëndetësore	127	127	Shërbim Shëndetësor	Bashkia Shkodër	Bashkia Shkodër	
		5/311+1-6			127	127				

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.

3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit Nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar.

Miratur me 24 vota

Vota Pro 24

Vota Kundër 12

Vota Abstenim 1

Zbardhur me datë 31.01.2025

SEKRETARE

Sabina Danaj




Adresa: Rr. “13 Dhjetori”, Nr.1, Shkodër, web: www.bashkiashkoder.gov.al, e-mail: info@bashkiashkoder.gov.al